

HATIXHE HOXHA

**PROF. EQREM ÇABEJ DHE STUDIUESIT SLLAVË PËR
AUTOKTONINË E SHQIPTARËVE NË DRITËN E EMRAVE TË
VENDEVE**

Që herët studiuesit që u morën me prejardhjen e popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe, u interesuan krahas këtyre çështjeve edhe për vendbanimin e popullit shqiptar, prandaj krejt e natyrshme ishte edhe pyetja e shtruar shpesh nga studiuesit e ndryshëm se a thua shqiptarët janë autokton në trojet ku sot gjëllin, apo janë të ardhur nga vise të ndryshme në këto anë?

Çështja e autoktonisë së popullit shqiptarë i ndau studiuesit në dy grupime të mëdha, pra disa mbështetën faktin se shqiptarët janë autokton në këto troje, ndërsa të tjerët ishin kundër autoktonisë së tyre.

Kur flasim për autoktoninë thotë prof. Çabej s'është fjala këtu për një autoktoni absolute, por me dobi thotë ky autor, është të bëjmë pyetjen a janë shqiptarët autokton në viset ku sot gjëllin që nga koha greko-romake?

Kundër autoktonisë së shqiptarëve ishin edhe studiuesit si: Waeigand, S. Puscariu, V. Parvani, P. Skok, H. Bariq, I. Popoviç etj.

A. M. *Selishqev*, autor rus u mundua përmes argumenteve gjuhësore të dëshmonte se sllavët kishin ardhur herët në Shqipëri, dhe se ata kur erdhën në këto anë, në shek. VII e VIII dhe zunë vend në Shqipërinë greko-romake, d.m.th. në Shqipërinë bregdetare, nuk i hasën aty shqiptarët, por takuan një popullsi romane¹.

Petar Skoku, romanisti dhe ballkanologu i shquar, në studimet e tij mbi toponomastikën e Ballkanit e në këtë mes edhe të Shqipërisë, e veçmas të Shkodrës me rrethinë, ishte shprehur se në periudhën antike nuk pati hasur gjurmë të shqiptarëve. Pra ai mbështeste mendimin se kur sllavët erdhën në Ballkan aty nuk ishin aty shqiptarët².

Henrik Baiq, në lidhje me vendformimin e popullit shqiptar ishte shprehur se, pasi që në gjuhën shqipe ruhen elemente nga huazimet e lashta greke, atëherë kjo gjuhë duhet të ketë qenë pranë greqishtes, dhe se për këtë na jep lajme me rëndësi edhe toponomastika e në saje të këtyre fakteve ai nxjerr përfundimin se vendformimi i popullit shqiptar është Dardania e lashtë. Për ta përforcuar këtë mendim ai sjell edhe shumë fakte të tjera, si sqarimin e shumë emrave antik të Dardanisë, përmes shqipes si p.sh. emri i qytetit Nishi-

¹ Osman Myderrizi, *Toponomastika jonë dhe disa çështje të historisë së popullit tonë*, në Konferenca e II e studimeve albanologjike, Tiranë, 1968, f. 163.

² Idriz Ajeti, *Zhvillimi i gjuhësisë shqiptare në Jugosllavi*, në "Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare", Prishtinë, 1976, nr. 2, f. 31.

Naissusi antik, mund të shpjegohet vetëm përmes ligjeve fonetike të shqipes, përkundër mendimit të shumë studiuesve sllavë, të cilët mendonin se ky emër mund të shpjegohet vetëm me anë të ligjeve sllave³.

Bariqi mendon se vendosja e shqiptarëve në brendësi të Gadishullit Ballkanik duhet të ketë ndodhur valë-valë, por jo më vonë se shekulli VI. Me këtë qëndrim, Bariqi rrëzoi mendimin e Selishqevit e autorëve të tjerë sllavë, që thoshin se shqiptarët kanë ardhur vonë në këto troje dhe atë pas sllavëve. Pra, këtë mendim thellësisht të gabuar të tyre, Bariqi e luftoi me mjete gjuhësore, dhe tha se këtë na e dëshmon toponomastika e cila sqarohet me anë të ligjeve të shqipes, të cilat ligje kanë ndodhur para ardhjes së sllavëve të jugut në territorin historik shqiptar. Në të mirë të këtij mendimi ai sjellë fakte të shumta, si p.sh.: Emri i lumit Buna, që në antikë, thotë Bariqi, ka qenë Barbanna e i cili përmes ligjeve të shqipes ka kaluar në trajtën e sotme, Buna, kështu në fillim kishim: Barbanna-Buna, ndërsa në sllavishte evoluoi në Bojana⁴.

Prof. Eqrem Çabej ishte shprehur, disa herë, kundër të gjithë atyre që shqiptarët i kishin vendosur në një territor si: Dakia, Trakia, Mezia, ose në një territor edhe më të ngushtë si: Dardania apo Mati, sepse toponimet e lashta të shqipes, si dhe një varg argumentesh jashtgjuhësore, dëshmojnë se populli shqiptar është formuar në një territor mjaft të gjerë. Ndërsa, territori historik i shqiptarëve në mesjetë, shprehet ky autor, duhet konsideruar si rezultat i një tkurrjeje historike dhe jo i një ekspansioni biologjik.

Për përcaktimin më të saktë të një gjuhe dhe autoktoninë, rëndësi shumë të madhe kanë edhe emrat e vendeve, të cilët ndryshojnë më ngadalë, ata shumë më vështirë u nënshtrohen ndikimeve nga jashtë, gjë të cilën e bëjnë më lehtë emrat e njerëzve. Mendohet se shumica e emrave të lashtë që shtriheshin në Ilirinë antike janë krijuar me lëndë vendi, këtë na e dëshmon zbërthimi i tyre përmes gjuhës shqipes, ose se ata sqarohen vetëm përmes ligjeve fonetike të shqipes. Ky fakt na bind se këta emra kanë qenë pandërprerë në gojën e shqipfolësve.

Studiues të ndryshëm, mbështetës të teorisë ilire, mendonin se po të analizohen emrat e vendeve, maleve, lumenjve etj. të peridhës antike, të Ilirisë, gjejnë paralelizmat e tyre në gjuhën shqipe, p.sh. **Arb**: Arba, Arbanon, Arbatis; **Barb**: Barbanna, Metubarbis; **Bor**: mons Borea, Boreas; **Brind**: Brindia, Brendesion; **bul**: Bulinoi, Bulliones, Bulentum; **Dalm-Delm**: Delmion, Dalmatae, Delminium; **Gen**: Genusus, Genysios; **Lamë**: Lamatis, Lametus; **Mal**: Dimallum, Malontum, Maleventus, Malontina, Malvesa (qytet); **Met**: Metulon, Metubarbis; **Parth**: Parthinin, Parthos; **Sol**: Solona, Sallontum, Sallentini; **Skard**: Skardona, Skardon; **Tar**: Tara, Taras,

³ Henrik Bariq, *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1955, f. 49-50.

⁴ Henrik Bariq, *Lingvistiçe studije*, Sarajevo, 1954, f. 28.

Tarentum; **Terg**: Tergeste, Opitergium, Tergolope, Tragurium; **Ulk**: Ulkinion, Ulcirus, Ulcisia castre etj.⁵

Emra të cilët i përmendëm më lart, dhe të tjerë, studiuesit menduan se mund të sqarohen vetëm përmes leksikut të shqipes si: p.sh. **Brigeste**: bigë (mal me dy maja, maje mali); pastaj emri **Borea** u afrua me fjalën borë të shqipes; **Brindia**, **Brundisium**: bri-brini; **Dardania** me fjalën dardhë; **Lamatis** me lamë, lëmë; **Mathis** me mat; **Metubarbis** me mjet: **Ragusium** me Rush (rrush) etj.

Studuesja e shquar E. Durham ka vërejtur se në sllavishten jugore dhe në gjuhën shqipe janë të shpeshtë emrat e viseve nga emra bimësh, p.sh. *dardhë-Dardania*: *rush-Raguza*, etj...⁶

Edhe emrat e tjerë të lashtë që janë krahasuar me shqipen i kanë vërtetuar po këto lidhje, në mes ilirishtes e shqipes, si p.sh. *Tara*, emër i lumit, bashkë me emrin e popullit *Autariatae* që lidhet me të dhe me *Taros*, *Tarentum* e me emra të tjerë përkatës, këndeje e andej Adriatikut është afruar me shqipen, “ter, thaj” nga një tar e me shterr, shterroj, shterrshëm”.⁷ Nga emir *Tarentum* i dikurshëm është bërë *Otrantoja* e sotme.

Prof. Idriz Ajeti, thotë se emir *Tara* na del si emër lumi, por *Tara* mund të jetë edhe emër vendi, kryesisht janë këto vende të ngritura buzë lumenjve që mbajnë kesi emrash e që ky studiues beson se ky emër lidhet me faktin se këta lumenj gjatë verës shterronin, thaheshin.⁸

Edhe emir i toponimit **Lama**, në Apuli dhe apelativi lama u afrua me shqipen lëmë, lamë që d.m.th. kënetë, moçalishte ose lama e luftës etj.⁹ Studiuesi i shquar N.Jokli emrin e toponimit antik **Rihzon** të gjirit të Kotorrit e afroi me fjalën shqipe rrjedh, rrodha, pra sipas tij emir *Rizon*, d.m.th. “ujë që rrjedh”.¹⁰

Edhe emrin e vendit, **Vendenis** të cilin e përmend Ptolomeu në shek. II të e.s. në veprën e tij: “Geografia”, G.Meyer e shpjegonte si lokativ të pluralit prej *Vend-en*, në *Vend-en-i-s(u)* e sipas këtij autori, lokativi i pluralit me (s)

⁵Eqrem Çabej, *Ilirishtja dhe shqipja*, në Përparimi, nr. 5, Prishtinë, 1970, f. 524-527.

⁶Eqrem Çabej, *Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe*, në “Jehona”, nr. VII, Shkup, 1972, f. 57.

⁷Eqrem Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, B.U.Sh., S.SH.SH. nr. 3, Tiranë, 1963, f. 69.

⁸Idriz Ajeti, *Diskutim*, në Simpozijum o ilirima u antičko doba, 10 do 12 maja, 1966, Sarajevo, 1967, f. 171.

⁹Idriz Ajeti, *Diskutim*, në Simpozijum o ilirima u antičko doba, 10 do 12 maja, 1966, Sarajevo, 1967, f. 172.

¹⁰Idriz Ajeti, *Diskutim*, në Simpozijum o teritorijalnom i hronoloskom razbraničenju ilira u praistorijska doba, odrzan, 15 i 16 maja, Sarajevo, 1964, f. 258.

ekzistonte edhe në gjuhën shqipe, pra prej këtij shembulli shihet lidhëshmëria gjuhësore midis toponimit antik dhe gjuhës shqipe.¹¹

P.Skok bëri një punë të rëndësishme në mbledhjen dhe zbërthimin e materialit gjuhësor shqip, kështu ky autor disa emra të lashtë ia ktheu shqipes dhe tha se këta emra mund të zbërthehen vetëm me anë të gjuhës shqipe. Kështu ky studiues emrin e oronimit **Dinara** e afroi me emrin e fisit ilir *dindarët*.¹²

Një vend me rëndësi, për përcaktimin e prejardhjes së gjuhës shqipe, zënë edhe hidronimet, kështu studiuesi I. Popoviç, shprehej se lumenjtë më të rëndësishëm në (ish Jugosllavi), mbanin emra jo sllavë, si: p.sh. *Danubi, Sava, Drava, Drina, Morava*, etj. nuk kanë emra grekë, por ndoshta, thotë ky autor, këta janë emra ilirë.¹³ Këtij grupi ia shtojmë edhe emrat e tjerë si: *Drin-Drinus, Mat-Mathis* etj...emra këta që u përmendën që te Vibius Sequester e gjer më sot qenë vazhdimisht në gojën e shqipfolësve.

Emri i lumit **Dri**, më herët na shfaqet si Drinus e më vonë si Drin e Dri, te ky emër haste e ruajtur rrënja dri-dra që është e ngjashme me formën dra të indoevropianishtes e që d.m.th. “ecën, rrjedh”, pra emir Dri-Drini do të thotë lumë që rrjedh.¹⁴

Këtij grupi, studiuesi Henrik Bariq ia shtoi edhe emrin e hidronimisë Buna, emër ky që prej shumë studiuesish, si: P. Skok, I. Popoviç etj. u mor si emër që duhet shpjeguar përmes sllavishtes, përkundrazi, Bariqi tha se ky emër mund të shpjegohet vetëm përmes ligjeve fonetike të shqipes.

Petar Skok dhe Henrik Bariq grupit të emrave ilirë që po shpjegohen përmes ligjeve fonetike të shqipes i shtuan edhe disa emra të tjerë si: *Astibos, Scupi, Naissus, Lychnidos* etj. Studiuesit që i cekën më lartë mendojnë se, emir i Astibos-it të lashtë evoluoi në emrin Shtip (Maqedoni), vetëm sipas ligjeve të shqipes, ku ky emër humbi silabën nistore të patheksuar, për arsye se kjo ishte një rregull që sundonte në gjuhën shqipe dhe e cila kishte përfshirë edhe shumë huazime romane në gjuhën shqipe si p.sh. *amicus-mik; arguntum-argent*, etj. Pastaj **s**-ja kaloi në **sh**, ndërsa më vonë me shurdhimin e **b-p**, rregull kjo shumë e përhapur në gjuhën shqipe, nga emir antik, Astibo, u përftua emir i sotëm Shtip.¹⁵

Studiuesit që i përmendëm më lartë, mendonin se në bazë të ligjeve të shqipes u përftua edhe emri i qytetit të Shkupit nga Scupi antik. Mirëpo,

¹¹ Exhlale Dobruna, *Mbi disa toponime të kohës antike në Kosovë*, në Onomastika e Kosovës, Prishtinë, 1979, f. 35.

¹² Petar Skok, *Arhiv za arbanasku starinu jezika i etnologiju*, I, Beograd, 1923, f. 15.

¹³ Ivan Popoviç, *Shënime për emrat gjeografik në vendet shqiptare*, “Përparimi”, nr. 10-12, Prishtinë, 1957.

¹⁴ Exhlale Dobruna, *Vepra e cituar*, f. 43.

¹⁵ Henrik Bariq, *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1955, f. 49.

studiuesi N. Jokli dhe disa studiues të tjerë ishin të mendimit se Shkodra dhe Shkupi, kurrsesi s'mund të jenë përfuar nga Scodra e Scupi antik, sepse grupi konsonantik **sk**-nistor, asnjëherë sipas ligjeve të shqipes nuk jep **shk**, për arsye se, thonë këta autorë, një **sk** e lashtë në shqipe ka dhënë **h** e kjo mund të shihet në këto raste si: *gnoska-njoh*, etj. Mirëpo sot dihet se grupi konsonantik **sk** i fjalëve të vjetra dhe i huazimeve, ka pësuar në shqipen dy shkallë përfaqësimi si: p.sh. **sc**- më e lashtë reflektohet në gjuhën shqipe me **h**, si p.sh. *scelo-hollë*, ndërsa në periudha më të vona ky tog na reflektohet si **shk** e kjo dëshmohet me latinizmat: *scamnus*, shqip: shkamb-shkëmb etj.¹⁶

H. Bariqi ishte i mendimit se edhe emir i Naissusit të lashtë evoluoi në Nishin e sotëm, në pajtim me ligjet fonetike të shqipes e kurrsesi sipas ligjeve të sllavishtes. Kalimi i **ai**-së në **i**-, si dhe dyfishimi i **s**-së, ishin zëvendësime normale në gjuhën shqipe.¹⁷

Henrik Bariqi ishte gjithashtu i mendimit se edhe trajta e sotme e emrit **Ohër**, sllavisht **Ohrid**, në mënyrë të rregullt duhet të ketë përfunduar me ndërmjetsimin e shqipes nga **Lychnis-Lychnidos**-i antik: **n**-ind. pas guturaleve në gjuhën shqipe kryesisht është shëndrruar në **r**-p.sh. ind. e vjetër gna, në shqipen kemi grue-grua.¹⁸

Duke i krahasuar shumë toponime e antroponime ilire me ato shqiptare studiuesit panë se përveç në kuptimin e përafërt që kishin këta emra, ata edhe përkah struktura e formimit gjasonin në mes vete. Mund të themi se kemi paralelizma mes ilirishtes dhe shqipes edhe sa u përket prapashtesave, si: p.sh. është e shpeshtë prapashtesa: **-at**; **-ata**; **-ates**; gjatë formimit të emrave të banorëve, fiseve, vendeve etj. Si: *Olciniatae*; *Olcinium*; *Docleates* e *Dokleatae*, *Labeates*; *Sardeates* etj., e ngjashme me prapashtesën **-at**, të emrave të vëllezërive, çetave, vendeve etj. Si: p.sh. *Demat*, pastaj te emrat e fshatrave e lagjeve: *Dukat*, *Bushat* etj.¹⁹

Është vënë në dukje nga shumë studiues lidhja e prapashtesës ilire: **-inium**; që del në shumë emra vendesh si: *Ulcinium*, *Dlminium*, *Leusinium* dhe prapashtesës shqipe: **-inj**; shumësi I disa emrave si: *krimb-kërminj*; *thelb-thelpinj*; *kopsht-kopshtinj* etj.²⁰

Një hallkë tjetër e vargoit të coptuar që lidh ilirishtën me shqipen është edhe nyja, veçanërisht nyja e prapme. Nyja e prapme përveç se në gjuhën shqipe haste edhe në rumanishte, bullgarishte e maqedonishte. Studiuesit si H. Bariqi, Al. Rosseti dhe Vl. Georgiev, mendojnë se nyja e prapme e shqipes

¹⁶ Androkli Kostallari, *Diskutim*, në "Studime ilire, II, Prishtinë, 1978, f. 319.

¹⁷ Henrik Bariqi, *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1955, f. 49.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Domi, Mahir, *Prapashtesa ilire dhe shqipe përkime dhe paralelizma*, në "Studime ilire, II, Prishtinë, 1979, f. 105.

²⁰ Po aty.

është mjaft e lashtë dhe ata mendojnë se burimin e kësaj nyje duhet gjetur në trakishte.

Prof. E. Çabej thotë se nuk duhet lënë anash faktin se nyja e prapme që del në shumë emra visesh në Shqipëri si te Scupi apo te Scodra është identike me nyjet te emrat e ngjashëm si: mali, ara etj.

Për përcaktimin e lidhjeve iliro-shqiptare një vend me rëndësi zë edhe theksi. Studiuesi H. Krahe u mor me studimin e këtij problem, ai tha se ilirishtja ka pasur theks inicial, d.m.th. në ballë të fjalës, ashtu si gjuhët protogjermanike...ndërsa shqipja ka theks dinamik, të rregulluar mekanikisht dhe i cili bie në rrokjen e parafundit që nga koha romake. Kalimi i theksit prej një pozite në një tjetër do të kuptohet nëse shpjegohet historikisht e thuhet se kjo gjendje është pasojë e zhdukjes së shpeshtë të rrokjes së fundit, për ç'shkak ai u vendos në silabën e parafundit, kështu pra nga theksi nistor kaloi në atë në rrokjen e parafundit. Ky fakt është me shumë rëndësi se flet për një element të përputhjes në mes ilirishtes dhe shqipes. Këtë gjë e ka shpjeguar shumë mirë N. Jokli, duke i ilustruar me shembuj nga toponimia, si p.sh.: Drivastum-Drisht; Issamnus-Ishëm; Dyrrachium-Durrës etj. Këtë gjë thotë P. Kretscheri e vërtetojnë edhe disa shembuj nga mesapishtja si: Brundisium-Brindisi; Hyndruntum-OtrantoTarentum-Taranto etj.²¹

Me interes na duket të ndalemi pak në këtë punim edhe në faktin se a ka gjuha shqipe terminologji të vetën detare apo jo? Qysh nga studiuesit Ëëigand, Georgiev, Bariq, Popoviç, Skok etj., është thënë se gjuhës shqipe i mungon terminologjia detare. P. Skok në veprën e tij: "Dolazak Slovena na Mediteran", duke folur për shqiptarët në mesjetë pohon se këta janë një popullsi koktinentale e baritore e cila nuk di gjë, për detari dhe s'tregon kurrfarë interesimi për r të dhe se ata nuk kanë kurrfarë terminologjie detare të veten " Terminologjia e tyre detare-peshkatore, sa e kam vërejtur në Ulqin, në pjesën më të madhe është sllave"²².

Studimet e bëra nga ana e studiuesve shqiptarë tregojnë se shqipes nuk i mungon terminologjia detare, sepse në këtë gjuhë ka shumë fjalë që lidhen me detin dhe peshkatarinë... Në fund, mbi terminologjinë detare mund të themi edhe këtë, se të gjitha ato fjalë shqipe që u ruajtën në leksikun detar, si dhe fjalët e huazuara, që i takonin koinesë së popujve Mesdhetarë dëshmojnë se populli shqiptar është autokton në këto vise ku sot jeton dhe se nuk ka qenë deti i huaj për të.

Ndër argumentet që flasin për një burim ilir të popullit shqiptar përveç elementeve gjuhësore dhe historike një vend me rëndësi zënë materialet e sjella nga arkeologjia, etnografia, etnologjia si dhe nga shkencat tjera ndihmëse.

²¹ Eqrem Çabej, *Ilirishtja dhe shqipja*, në "Përparimi", nr. 5, Prishtinë, 1970, f. 532.

²²Ruzhdi Ushaku, *Kërkime filologjike*, Prishtinë, 1971, f. 100.

Kështu studiuesit duke i analizuar me kujdes materialet e mbledhura etnografike, gjetën aty një varg elementesh të cilat buronin drejtpërsëdrejti nga pasuria ilire parahistorike. Veçanërisht gjurmët ilire hasen në veshjet popullore të shqiptarëve të sotëm, mandej në ornamente, në simbole, në valet popullore, në muzikë etj.

Edhe të dhënt arkeologjike përforcojnë tezën mbi prejardhjen ilire të popullit shqiptar. Këtë mund ta ilustrojmë edhe me thëniet e studiuesve, p.sh. arkeologu Italian, Luigi Ugolini, ja se çfarë tha: “Arkeologjia jep argument më të mira se populli shqiptar posedon kontinuitetin antik dhe që i takon njëres prej racave më të lashta të Evropës e ruajtur gati në mënyrë të mrekullueshme deri më sot e paprekur.”²³ Studiuesi tjetër, Jorzi Neustupni, duke folur mbi kulturën e hallshtatit ndër të tjera thotë: “Qenja, pozita e kësaj kulture shihet qartë se bartësit e saj të saktë para se gjithash kanë qenë ilirët popull i grupit gjuhësor indoevropian mbeturinat e të cilit janë shqiptarët e sotëm.”²⁴

Cfarë mud të themi në fund në lidhje me autoktoninë e popullit shqiptarë, dhe të gjuhës së tij? Ne mund të nxjerrim përfundimin se të arriturat shkencore nga shkencat si: gjeografia, historia, gjuhësia etj., flasin në të mirë të autoktonisë së shqiptarëve në trojet në të cilat ata edhe sot jetojnë. Prof. Çabej thotë se emrat e lashtë të maleve, lumenjve, qyteteve etj., në Ilirinë antike, nga Raguza e deri te Nishi, Shkupi, Shtipi, mali Sharr e deri te Ohri, në njërën anë e mëtutje deri te deti Adriatik e ai Jon, e deri te Çamëria, të gjithë këta emra ruajnë format karakteristike të evolucionit fonetik të shqipes. E gjithë kjo është një argument fort i rëndësishëm që dëshmon se këto toponime kanë qenë vazhdimisht në gojën e shqipfolësve. Por, prof. Çabej mendon se këto toponime na tregojnë edhe se populli shqiptar është formuar në një territor mjaft të gjerë. Ndërsa, territor historik i shqiptarëve në mesjetë duhet konsideruar si rezultat të një tkurrjeje historike e jo i një ekspansioni biologjik.

²³ Zef Mirdita, *Patricuale Illyrica etj. Albanika*, “Përparimi”, nr. 8, Prishtinë, 1972, f. 673.

²⁴ Po aty.

